

Arrestohet një person në Prizren, gjuajti me armë në një aheng



27/07/2025 09:36

f

t

l

Një person është arrestuar në fshatin Korishë të Prizrenit mbrëmjen e 26 korrikut, pasi dyshohet se ka shtënë me armë zjarri gjatë një ahengu familjar.

Sipas njoftimit 24-orësh të Policisë së Kosovës, rreth orës 22:45, i dyshuari – një mashkull me shtetësi kosovare – kishte shtënë me një armë automatike të llojit AK-47. Nga vendi i ngjarjes janë sekuestruar një armë me 10 fishekë dhe janë gjetur katër gëzhoja, transmeton [lajmi.net](#)

Pas arrestimit, i dyshuari është shoqëruar në stacionin policor dhe, me vendim të prokurorit, është dërguar në mbajtje.

Policia po vazhdon hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të rastit./[Lajmi.net/](#)

LAJME TË FUNDIT

- Kryeprokurori Isufaj: Radoiçiçi kërkoi heqjen e urdhër-arrestit në...
- Vuçiq: Nuk vendosim sanksione ndaj Rusisë, Staroviç foli pa kujdes
- Numër i madh i vatrave të zjarreve edhe...
- Ndërtimtaria sektor me rrezik të lartë, kërkohen masa nga Inspektorati

Artikuj të ngjashëm



July 27, 2025
Kryeprokurori Isufaj: Radoiçiçi kërkoi heqjen e urdhër-arrestit në këmbim të informatave...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
B.r. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

- Fact-Checking Policy

Ethics Policy

Corrections Policy

Ownership & Funding Information

Editorial Team Information